



Në mbështetje të nenit 5 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.5, nenit 11 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1, nenit 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 7 paragrafi 4 të Rregullores nr. 01/2018, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 01/2014 dhe Rregullores Nr. 01/2017 të Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, lidhur me nenin 29, paragrafi 4 të Ligjit Nr.08/L-017, për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, me datë 09.12.2022, nxjerrë këtë:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti nr.AKK-DPKI-06-2968/22, lidhur me pretendimet e ngritura për konflikt të interesit për zyrtaren e lartë znj. Donika Gërvalla Schwarz, Ministre e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporë, për shkak se nuk ka prova të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit në lidhje me vendimmarrjen lidhur me personin e afërm të saj.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin për konflikt interesi, për zyrtaren e lartë znj. Donika Gërvalla Schwarz, është trajtuar sipas procedurës së paraparë me Ligjin nr. 06/L-011, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (në vijim: Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit).

Ky rast ka filluar të trajtohet pas informatës së pranuar nga jashtë (në vijim: raportuesi i rastit), ku janë ngritur pretendime për konflikt të interesit, si në vijim: “[...] ...në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës nga vajza e Ministres së Jashtme znj. Donika Gërvalla-Schwarz, N. Sch i është lëshuar një certifikatë e pazakontë për kryerje të praktikës në zyrën e nënës së saj në MPJD për nevoja të shkollimit të saj në Gjermani, pa e kryer fare.[...]”.

Pasi është shqyrtuar dhe analizuar informata e pranuar nga jashtë, me qëllim të sqarimit të gjithanshëm të këtij rasti është realizuar një takim në Agjenci me znj. B.H, Asistente Personale e Ministres së Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës (në vijim: MPJD), e cila dyshohet të jetë nënshkruese e Certifikatës që N.Sch., e ka marr nga MPJD dhe Deklaratës për pranimin e saj në MPJD. Pas ballafaqimit të informacioneve dhe fakteve që posedon Agjencia, znj. B.H. ka deklaruar se “rasti në fjalë në fakt nuk ka ndodhur fare, dhe se dokumenti në fjalë është hartuar në mënyrë të tillë për të shërbyer si ‘karrem’ për t’i zbuluar ata që po nxjerrin informacione të paautorizuara jashtë kabinetit të ministres”.



Agjencia pasi ka dëgjuar me vëmendje znj. B.H, të njëjtës i ka kërkuar që lidhur me rastin në fjalë dhe deklaratat e bëra në takim, t'ia përcjell Agjencisë edhe në forme të shkruar, gjë të cilën znj. B.H. e ka bërë përmes shkresës DPKI-06-3631/22, datë 26.08.2022.

Në deklaratën me shkrim, znj. B.H. ka theksuar se, citoj: *“Pas kërkesës për takim/informacion plotësues nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit rasti DPKI-06-2968/22, unë B.H. deklaroj se dokumenti i përmendur nga ju gjatë takimit tonë është i nënshkruar nga unë, në koordinim me eproren time. Arsyeja e hartimit të dokumentit ka qenë për të konstatuar se cili është burimi i rrjedhjes së rregullt të informacioneve brenda kabinetit, edhe rreth temave që prekin çështje të sigurisë nacionale, për të cilën në të kaluarën e kemi njoftuar (pa rezultat) Prokurorinë Speciale, e cila lëndët e hapura i ka mbyllur pa arritur asnjë përfundim. Qëllimisht është zgjedhur një temë provokuese, por pa implikime ligjore as në fushën e korrupsionit dhe as atë financiare. Dokumenti i mësipërm asnjëherë nuk është i protokoluar, nuk është ekzekutuar dhe nuk ka dal jashtë zyrës sonë. Vetëm është futur në dosjen e emërtuar ‘arkivi 2022’ brenda zyrës sonë, nga ku pa dijeninë time i është dërguar medimeve të ndryshme, në përpjekje për të diskredituar personalitetin e eprores sime”.*

Me pas, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, përmes shkresës zyrtare (DPKI-06-01/3959/22), ka kërkuar nga zv. Sekretari i Përgjithshëm i MPJD-së informacion nëse, znj. N. Sch. ka ndjekur praktikën dhe me atë rast është lëshuar certifikatë (Praktikumszeugnis) për kryerjen e kësaj praktike për të, në kabinetin e Ministres së Ministrisë së Jashtme dhe të Diasporës, për nevoja të shkollimit të saj në Gjermani, dhe në përgjigje zyrtare të zv. Sekretarit të Përgjithshëm të MPJD-së (DPKI-06-01/3959-1/22), thuhet se: *“Duke marrë parasysh kërkesën tuaj AKK-DPKI-06-2968/22 lidhur me znj. N. Sch., ju njoftojmë se si Zyre e Sekretarit të Përgjithshëm nuk kemi lëshuar ndonjë dokument lidhur me personin N. Sch.. Po ashtu as Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore nuk ka lëshuar ndonjë dokument të tillë”*

Nga informacioni dhe dokumentacioni në dispozicion, sqarimet dhe deklaratat e mësipërme të zyrtarëve të lartë të MPJD-së, rasti paraqitet të jetë fiktiv dhe i inskenuar për arsyet e cekura mësipër nga zyrtarët në fjalë të MPJD-së, dhe rrjedhimisht znj. Donika Gërvalla Schwarz nuk është (nuk ka mundur të jetë) përfshirë në ndonjë vendimmarrje lidhur me rastin në fjalë.

Në këtë mënyrë, me dispozitën e nenit 17 [Deklarimi rast për rast i interesave private të zyrtarit], paragrafi 1 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit është përcaktuar se:

“1. Çdo zyrtar gjatë ushtrimit të funksionit të tij publik, në bazë të njohurive të tij dhe në mirëbesim, detyrohet që të bëjë vetëdeklarimin paraprak, rast për rast, të ekzistencës së interesit të tij privat ose të personave të afërm me të lidhur me vendimmarrjen në një çështje të caktuar, që mund të bëhet shkak për lindjen e një konflikti të interesit dhe të tërhiqet nga kjo vendimmarrje.”

...lidhur me dispozitën e nenit 3, paragrafi 1, nënparagrafi 1.12 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, e cila definon nocionin vendimmarrje si:

“çasti i fundit i procesit vendimmarrës gjatë të cilit vendoset përmbajtja përfundimtare e aktit apo kontratës si dhe ato çaste paraprake të vendimmarrjes të cilat janë thelbësore dhe përcaktuese në të cilat pjesëmarrja, ndikimi dhe qëndrimi i zyrtarit përcaktojnë përmbajtjen

përfundimtare të aktit apo kontratës si dhe çdo veprim i zyrtarit në ushtrimin e funksionit publik”.

Në rastin konkret dhe në kuptim të dispozitave të sipërcituara, fakti që znj. Donika Gërvalla Schwarz e ka person të afërm (vajzë) znj. N. Sch., që sipas raportuesit të rastit e njëjta pretendohet të ketë marr një certifikatë në MPJD, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, vlerëson se kjo situatë, edhe pse mund të perceptohet, nuk paraqet *a priori* konflikt të interesit, pasi që konflikti i interesit është i lidhur ngushtë me procesin e *vendimmarrjes*, ndërsa znj. Donika Gërvalla Schwarz nuk është gjetur të jetë përfshirë në ndonjë *vendimmarrje (përfshirë çastet paraprake të vendimmarrjes)* në këtë rast.


Gjithashtu, në këtë rast, nuk ka njoftim me shkrim nga MPJD, e as nuk është gjetur ndonjë provë që në rastin konkret znj. Donika Gërvalla Schwarz të ketë ushtruar ndikim *të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, haptazi apo në mënyrë anonime*, në ndryshimin e vullnetit të ndonjë zyrtari gjatë dhe lidhur me ushtrimin e funksionit publik, konform nenit 16 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

Andaj, në bazë të vlerësimit të gjendjes faktike si më lartë, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit duke u mbështetur në dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, konstatoi se nuk ka prova të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit në rastin konkret sipas pretendimeve të raportuesit të rastit dhe vendosi si në pikën I. të dispozitivit të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18, paragrafi 11, të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, lidhur me nenin 29 paragrafi 4 të Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, Agjencia mund të rihapë rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik,
- Drejtorit të DPKI-së,
- Zyrtarit përgjegjës.


Yll Buleshkaj
Drejtor i Agjencisë
për Parandalimin e Korrupsionit

